

KOSOVARJA



**ARDITA
E ADRIANA MORINA**
të suksesshme, të zonja, të bukura...



Koha për dhuratat festive

DERI NË

50%

ZBRITJE



WWW.IAS-KS.COM



Ardita e Adriana Morina të suksesshme, të zonja, të bukura...

Në një shoqëri ku suksesi shpesh matet me zhurmë dhe ekspozim, Ardita dhe Adriana Morina përfaqësojnë një shembull tjetër: dy motra që kanë ndërtuar karrierat e tyre me punë të palodhur, përkushtim dhe integritet profesional. Secila në fushën e vet – njëra në botën e ligjit, tjetra në art dhe media, dëshmojnë se talenti, disiplina dhe eleganca personale mund të ecin krah për krah. Të ndryshme në profesion, por të bashkuara në vlera, motrat Morina janë shembull i grave të zonja, të suksesshme dhe të sigurta në rrugën që kanë zgjedhur.



Ardita Morina, avokatja që shkëlqen me profesionalizëm e bukuri

E lindur dhe e rritur në Prishtinë, Ardita Morina është një profil profesional që ndërtohet pa bujë, por me rezultate konkrete.

Janë bërë gjashtë vjet që ushtron profesionin e avokates, e fokusuar kryesisht në çështje civile, komerciale, administrative dhe penale – fusha që kërkojnë jo vetëm dije të thellë ligjore, por edhe maturi, etikë dhe përgjegjësi të lartë profesionale.

Rrugëtimi i saj nuk ka nisur drejtpërdrejt në avokaturë. Dymbëdhjetë

vjet Ardita Morina ka qenë pjesë e sektorit të sigurimeve, fillimisht si përfaqësuese ligjore dhe më pas si drejtoreshë e departamentit ligjor. Dhe, përvoja e gjatë i ka dhënë bazë të fortë praktike, veçanërisht në trajtimin e rasteve komplekse, interpretimin e kontratave dhe mbrojtjen e interesave institucionale.

Pikërisht kjo e bën sot një avokate që ligjin e shih jo vetëm si normë, por si instrument për zgjidhje reale dhe të qëndrueshme.

Në punën e saj, Ardita njihet për korrektësinë dhe seriozitetin në çdo rast. Ajo ndërton marrëdhënie besimi me klientët, duke i trajtuar çështjet me diskrecion, qartësi dhe përkushtim maksimal.

Për të avokatura është më shumë se profesion – është mision dhe përgjegjësi ndaj drejtësisë. Krahas profesionalizmit, shpesh përmendet edhe për paraqitjen e saj elegante dhe stilin e veçantë, duke e bërë figurën e saj edhe më të dallueshme.

Adriana Morina -

aktorja e suksesshme
që nuk e tradhton
televizionin

Adriana Morina është një emër i njohur për publikun kosovar, një artiste që lëviz me natyrshmëri ndërmjet teatrit, filmit dhe televizionit. Si aktore, autore dhe moderatore në Radio Televizionin e Kosovës, ajo ka ndërtuar një karrierë të shumanshme, duke ruajtur gjithmonë identitetin dhe zërin e saj artistik.

Është vlerësuar për rolet e saj në disa projekte filmike dhe televizive, ndër të cilat spikat filmi "Heroi", interpretimi që i solli çmimin "Aktorja më e mirë" në Festivalin e Filmit në Nju-Jork, një arritje që e pozicionon emrin e saj edhe në skenën ndërkombëtare.

Përveç filmit, Adriana ka qenë e pranishme në seriale dhe shfaqje teatrore, ku është vlerësuar për ndjeshmërinë, prezencën skenike dhe aftësinë për të ndërtuar personazhe autentike. Së fundi, ajo ka qenë pjesë e serialit "Tre Vllaznit", duke dëshmuar vazhdimësinë dhe seriozitetin e saj në skenën televizive kosovare. Në RTK, krahas rolit si moderatore dhe autore e emisionit muzikor "Rock n'Bllok", Adriana mban edhe pozitën e redaktores së Redaksisë së Muzikës, ku kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin editorial dhe promovimin e muzikës vendore.

Sidoqoftë, me energjinë krijuese dhe përkushtimin e saj, Adriana Morina përfaqëson figurën e artistes moderne kosovare: e guximshme, e përgatitur profesionalisht dhe e lidhur ngushtë me publikun.

SI TA PËRMBYLL KËTË SHKRIM?

Rrugët e Arditës dhe Adrianës janë të ndryshme, por thelbi i suksesit të tyre është i njëjtë: puna e ndershme, përkushtimi dhe besimi në vlerat personale.

Thënë shkurt, dy motra, secila në mënyrën e vet, e bëjnë mbiemrin Morina sinonim të profesionalizmit, bukurisë dhe suksesit.

Nderim Neziri





“Zgjedhjet nuk po ma hjekin kolicën nga dora!”

Në ditën e zgjedhjeve të 28 dhjetorit rastisa të isha në tregun e gjelbër të Prishtinës, për të mos thënë në tregun e turpit, për pamjet e tmerrshme në këtë treg nga papastërtia. E, kur bie shi, llastikët mbi kokat e njerëzve pikojnë si në kohën e vitit 1990 në Shqipëri, kur në autobus më ka ndodhur t’i shoh njerëzit me ombrella, sepse shiu që binte pikonte mbi kokat e tyre!

Por, ta lëmë pamjen e trishtueshme që ka ky treg, e të fokusohem te një detaj i asaj dite...

Teksa e pyes shitësin se sa kushtojnë bananet që i ka ekspozuar në treg, ai, në vend të përgjigjes, më thotë: “Blej banane se sot po formohet qeveria!”

“E, ç’kanë të përbashkët bananet tua me qeverinë?!” ia kthej unë.

“Kryesorja qeveria po formohet!”, ma ktheu ai.

“A formohet qeveria a jo ty nuk t’i shet bananet e as këtij burri që ndodhet pranë teje me kolicë nuk i hiqet kolica nga duart!”, ia kthej unë.

“Jo, valla, kolica kurrë nuk m’u hoq

nga dora, cilado qeveri që erdhi!”, më thotë burri me karrocë në dorë, i cili mezi i hidhte hapat njërin pas tjetrit, i fëmija kur fillon të ecë.

Dhe, ndalem e mendoj: Shih këtë popull tonin, nuk i intereson se a do të ketë farë fitimi nga shitja e bananeve, por merret me politikë!

Më shumë popullit tonë i intereson politika sesa puna e fitimi, mbajtja e familjes, e që është obligim parësor i çdo familjari.

Eh, të çuditshëm jemi!

I. ILAZI

NË NDËRRIM TË MOTEVE...

DIKUJT I MUNGON BUKA, DIKUJT DASHURIA!



I erdhi fundi edhe këtij motmoti.
Ftohtë.

Keq për skamnorët, të cilët i ngrohë
shpresa se do e presin pranverën, do presin
ditë më të mira...

Mirë për ata që e kanë nxehtë në shtëpi a
në ahengje, në atmosferë që kënaqen vetë
me të gjitha çka ia donë shpirti e zemra pa
menduar për të tjerët, pa menduar për ata
që e presin këtë festë me bukë e lang e ujë...
Sa qesharake është kjo botë: Dikujt i mun-
gon buka, dikujt i mungon dashuria, dikujt
të dyja...

Viti që po e lëmë pas, për fat të keq, ishte
vit i plasaritjeve politike për të formuar
qeverinë e re, e cila nuk arriti të formohet

edhe pse kaloi një vit i plotë.

Tash i patëm edhe zgjedhjet e reja për të
dytën herë sivjet, por kur do të formohet
qeveria e re, kur do të miratohet buxheti,
më thotë im mik.

Më zë ngushtë, nuk di ç'ti them...

Hej 2026-ta, e kam një besim në ty se boll
patëm zhgënjime!

Çdo gjë që dua t'më realizohet në ty, me
ty...

Ëndërr e mirë, por nashtë, e mirë edhe për
ata që në zhgjiëndërr vuajnë...

E mira dhe e keqja bashkëjetojnë në këtë
jetë.

E çuditshme a?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com



Atë që bëri profesor Nusret Pllana nuk e bënë institucionet!

Herë-pas herë Prof. Dr. Nusret Pllana është në mediet tona, por jo edhe aq sa duhet, sepse kontributi i tij është i madh. Kujt nuk i kujtohen fjalët “Ju flet Kosova e lirë! “Ju flet Kosova e lirë!”...

Ditë me parë në Televizionin “Dukagjini”, në rubrikën “Personazh”, i ftuar ishte Prof. Dr. Nusret Pllana, profesor i nderuar, njeri që i sensibilizoi masakrat serbe në Kosovë më shumë se që bënë institucionet e Kosovës, madje më shumë se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e që do duhej të dilte para opinionit tonë dhe atij ndërkombëtar me fakte të plota se ç’ndodhi me vjet të tëra në Kosovë në kohën e okupimit të saj nga Serbia që nga viti 1989 e deri në qershor të vitit 1999.

Profesori i nderuar, Nusret Pllana, jo vetëm që gjatë luftës ishte folës në radion e pavarur në malet e Ber-

ishës, por ai tuboi edhe të dhëna për masakrat e shumta që ndodhën në Kosovë, e në veçanti të vrasjes së 1432 fëmijëve shqiptarë nga okupatori serb, shifër që bëri të emocionohet dhe t’i mbushën sytë me lot herë pas herë.

Ai habitet me faktin se në televizionet tona asnjëherë qe 25 vjet nuk është organizuar asnjë debat për vrasjen e gjithë atyre fëmijëve, kurse në çdo mbrëmje dhe në secilin televizion, duke e përfshirë edhe atë publik, debatohet për tema të ndryshme politike, e veçmas me përplasjet ndërmjet “analistëve politikë” se kush do i fitojë zgjedhjet në nivel shtetëror,

kush do i fitojë zgjedhjet në nivelet komunale, cila parti ka më shumë shanse për të formuar qeverinë, e të tjera të ngjashme, e që janë bajatizuar aq sa në të shumtën e rasteve as që i shikon kush...

Sidoqoftë, me këtë rast zëmë në gojë disa nga projektet e shumta të profesorit të nderuar, meqë i tërë aktiviteti i tij është vështirë të përthekohet me një, dy a tri shkrime...


Libri i tij “The Terror of Invading Serbia over Albanians 1844-1999”, i përkthyer në tetë gjuhë (shqip, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, turqisht, serbisht, japonisht e suedisht), deri tani është promovuar në shumë

qendra evropiane dhe botërore, si në Prishtinë, Tiranë, Tetovë, Shkup, Oslo, Stokholm, Kopenhagë, Katovicë të Polonisë, Budapest, Romë, Helsinki, Vjenë, Lion, Paris, Shtutgart, Dortmund, Singen, Nyrnberg, Hechingen, Pforzheim, Hamm, Ludwigsburg, Helsingen, Heidelberg, Mannheim, Mynster, Gjenevë, Cyrih, Lugano, Ankara, Stamboll, Izmir, Brusë, Nju-Jork, Uashington, Floridë, Detroit, Melbourne, Toronto, Bearry, Bruksel, Berlin, Bolzano, Braunschweig, Londër, Mynster, Dyzeldorf dhe Montreal të Kanadasë.

Andaj, ky libër, ka arritur të futet në bibliotekat më të njohura evropiane e botërore, si në Bibliotekën Botërore të Kongresit Amerikan, në Bibliotekën Botërore Viktoria të Australisë, në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në Bibliotekën Botërore të Bajernit të Gjermanisë, në Akademinë Ushtarake të Bundesverit gjerman, në Tribunalin e Hagës, në Bibliotekën Botërore të Britanisë së Madhe në Londër etj.

Për librin "Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999", në vitin 2013 ka marrë mirënjohje nga Biblioteka Botërore e Kongresit Amerikan, si dhe Biblioteka Botërore e Britanisë së Madhe në Londër në vitin 2015.

Është autor i një mori punimesh shkencore, redaktor i librit "A vriten Engjëjt", të autores Hanëmshahe Ilazi, 2012; recensent i librit "Abdyl Krasniqi – frymëzues brezash", 2009, i autorit Prof. Bedri Tahiri; recensent i librit monografi "Dëshmorët e Kombit – Mareci '99", i autorit Refik Gërbeshi, 2014; recensent i librit "Familja Pllana – Halabak", 2012, i autorit Prof. Shaban Pllana; recensent i librit monografi "Masakra e Belegut", 2015, i autorit Mr. sc. Endrit Binakaj; redaktor i librit monografi "Studenti martir – Arianit Ilaz Berisha", i autorit Argjend Hasani, 2013; recensent i librit monografi "Spahijajt e Llashticës", Prishtinë, 2014; recensent i librit "Kapërcimshkulli", 2015, i autorit Musli Kabashi etj. Është autor edhe i shumë filmave dokumentarë, i ekspozitës me fotografi dokumentare "Ruga e Kosovës së Lirë", 1999; ditarit të luftës e shumë veprave të tjera... Aktualisht është ligjërues i Univer-



sitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës dhe Universitetit Shtetëror të Tetovës në Shkup dhe Tetovë. Thënë shkurt, atë që bëri Profesor Nusret Pllana deri më tash në sensibil-

izimin e luftës së Kosovës nuk e bëri as Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, e aq më keq as institucionet e Kosovës!

ISA ILAZI



S'ke para - s'ke as dashuri!

Disa thonë se paraja është çelësi i lumturisë. Por, sa është e vërtetë kjo kur dihet se shumë personalitete të njohura e me bazë të mirë materiale më shumë kanë probleme se çaste të lumtura?

ERA LATIFI: SA MË SHUMË PARA TË KETË MASHKULLI, AQ MË MENDJEMADH ËSHTË!

- Mendoj se sa më shumë para të ketë mashkulli, aq më mendjemadh është, sepse, siç thuhet edhe në popull, i rritet mendja!
Sidoqoftë, paraja është e nevojshme për mbijetesë, por jo edhe si mjet kryesor i

jetës, sepse ajo nuk ta ofron lumturinë, por lumturia krijohet me mirëkuptim e dashuri.

Të dashurin duhet ta vlerësosh e ta çmosh, ta duash si njeri për atë që është e jo për gjërat e mira materiale që ka dhe për jetën luksoze.

ARSIM KURTISHI: NUK E DUA FEMRËN TË PASUR!

- Nuk e dua femrën të jetë e pasur, sepse prej saj ka vetëm telashe, se është mësuar me jetë luksi...

Unë e kam partneren time dhe ia di vlerën: e çmoj dhe e respektoj pa kufi...

Për mua ka rëndësi të kem një jetë të qetë, normale dhe pa zënka e ofendime, e për para më mjafton të kem sa mos me hequr keq.

ALISHE GASHI: E DUA TË DASHURIN SE MA DO SHPIRTI...

- E dua të dashurin se ma do shpirti e jo pse ka veturë luksoze.

Me pak fjalë: E dua se ma do shpirti...

Thënë shkurt: Paraja nuk ka fare ndikim në dashurinë tonë, sepse ajo nuk është gjithçka...

ERMIR KRASNIQI: PËR DISA PARAJA ËSHTË GJITHÇKA!


- Në shoqërinë tonë gjithnjë e më shumë po vjen në shprehje paraja, e cila, pa dyshim, po ndikon edhe në një lidhje dashurie. Ajo po ndikon edhe në marrjen e vendimeve!

E, kjo është keq, sepse çifti që një ditë do mbetët pa para, do të reflektohet edhe në marrëdhënien e tyre, e ndoshta do të do të përfundojë edhe me ndarje...

PËR FUND

Nëse dashuron me zemër, me shpirt, mos u fokusoni te paraja, por te e ardhmja juaj, e cila, natyrisht, gjatë jetës do të ketë edhe tensione, gëzime e hidhërime, dashuri e vuajtje, çaste të vështira, por jo edhe të pakapërcyeshme...

Diturie Haxhaj



Urime 2026

Hotel Garden: +383 45 71 71 77; Garden Downtown: +383 48 71 71 77;
Website: www.hotelgarden-ks.com; Instagram: /garden_hotels

Sy më sy: Shemsi Krasniqi Shemi

Ka kohë që kam një dëshirë për një shkrim, për një intervistë sy më sy me Shemin. Sepse, këngët e tij jo vetëm që janë hite, por gjithmonë këndohen me ëndje, me mall, me ndjenjë, sidomos nëse në ato vargje gjen edhe diçka tënden... Dhe, ime dëshirë u realizua. Shemi nuk di t'i thotë jo "Kosovares", sepse mu në këtë revistë, shumë vite më parë, e ka pasur edhe intervistën e parë... E, të mos flasim se për "Kosovaren", siç thotë edhe ai vetë, ka mall, sepse e kthen në kohë të shkuar, në kohën kur ishte tinejxher.

"Sa e sa vite..." është një këngë jotja, e që aso kohe ishte hit e hit është edhe tash, sa herë që dëgjohet. Edhe ti, sa e sa vite je në skenë dhe gjithnjë e më i fuqishëm, më i adhurar. Hë, ç'thua për këtë?

- Sa e sa vite kaluan kur kisha intervistën e parë në revistën "Kosovarja" dhe prapë ja ku jemi... Përsëri bashkë...

Vërtet, në këto katër vitet e fundit të rikthimit tim në muzikë kam bërë mjaft dhe më nuk ndalem dot.

Filluat si grup më 1981 me emrin "Ilirët" dhe me këngën "Merita". Edhe sa Meritave të tjera u ke kënduar?

- Vërtet, u kemi kënduar shumë femrave shqiptare dhe përherë do të këndojmë për to. Por, njëherësh, kemi kënduar edhe për Mixhën Mursel. Të tillë jemi ne, "Ilirët"...

"Xhamadani vija-vija" është një këngë tjetër jotja e që të tjerët e këndojnë dhe mendojnë se janë të parët që e kënduan, madje edhe nga këngëtarë

shumë të njohur. Ke koment për këtë?

- Xhamadani është këngë që do të këndohet përherë se është bërë si himn kombëtar dhe mburremi që ne ia kemi vu kapakun. Por, nuk prish punë, edhe të tjerët le ta këndojnë, sepse, siç thash, tashmë kjo këngë është bërë himn dhe himnin ka të drejtë ta këndojë gjithsecili...

Sa këngë i ke deri tash, sa albume dhe sa videoklipe?

- Këngët s'i kam numëruar, por kemi mjaft, edhe pse ne më shumë u kemi dhënë rëndësi performancave "live" sesa studios. Po kështu, ne, "Ilirët", jemi të njohur si grup që bëjmë kërdi në koncerte, diskoteka etj.

Cila është kënga jote e fundit?

- Së shpejti del një duet yni me Shkenda Dubovën dhe kjo tash për tash do të jetë kënga më e re. Titullohet "Vitet në dashni". Shpresojmë shumë se edhe kjo këngë do të pritët mirë dhe të bëhet hit si të tjerat, e ndoshta edhe më e dëgjuar se të tjerat. Tash për tash mua më pëlqen shumë, e

besoj se një gjë e tillë do u ndodh edhe adhuruesve tanë...

Cila këngë jotja mendon se t'ka dhënë më shumë popullaritet?

- Pa mëdyshje, "Xhamadani vija-vija". Këtu s'ka koment...

A ke menduar se do të arrish këtë sukses që ke e do të bëhesh i famshëm sikur që je?

- Paj, dëshira ime dikur ka qenë të bëhem futbollist, por zgjodha këndimin dhe nuk kam gabuar aspak. Krijova famë të cilën do e lakmonte shumëkush. Por, famën është vështirë ta mbash nëse nuk ke ideologji, kurse unë me grupin tim e kemi ideologjinë tonë dhe kjo na bën të dallohemi nga të tjerët.

A merresh edhe me punë tjetër veç muzikës?

- Nuk merrem me ndonjë punë tjetër. Muzikën e kam pasur profesion. Por, tash më shumë këndoj për shpirtin tim dhe

këndimi më relakson. E ndiej veten mirë kur e kam mikrofonin në dorë...

Në vitet 90 je kudo nëpër Evropë në koncerte të ndryshme, kryesisht me Ganimete Abazin – Ganën. Ndonjë kujtim nga ajo periudhë jotja e artë?

- Me Ganën kam shumë kujtime dhe nuk di cilin ta veçoj. Megjithatë, në një koncert ma ka hequr kapelën nga koka dhe e ka hedhur në publik, e unë e gjuajta Ganin në publik...

Në fund të viteve 90 e lë këngën dhe në vitin 2009 u paraqite sërish në Sheshin e Prishtinës për Ditën e Pavarësisë. Kthimi yt u mirëprit nga adhuruesit e këngës tënde. Ç'të shtyri të rikthehesh në skenë përsëri?

- Nuk munda të duroj më gjatë pa dal në skenë, ani pse, vërtet, kam menduar të mos këndoj më. Por, dëshira e madhe për grupin tim më shtyri të kthehem përsëri në skenë dhe atë, madje, furishëm.

Çka ke fituar dhe çka ke humbur gjatë atyre 10 vjetëve dhe a je penduar ndonjëherë që u largova nga skena?

- Nuk pendohem që jam larguar nga skena, sepse gjatë asaj kohe i jam përkushtuar kryesisht familjes, e cila përherë ka qenë preokupim imi dhe për të kam sakrifikuar shumë. Sepse, nganjëherë nuk shkojnë gjërat ashtu si duam ne...

Ke famë e thonë se nuk je mendjemadh. Hë?

- Kurrë s'kam qenë mendjemadh dhe më vjen mirë që edhe të tjerët e dinë këtë gjë. Kurrë nuk e kam shfrytëzuar famën që ta shkel dikë, assesi. Madje, edhe me adhuruesit e mi kam qenë i hapur dhe i thjeshtë.

A ke pasur momente kur ke thënë "Ah, sa idiote është kjo jetë!"?

- Po, në jetë ka edhe momente kur nuk shkon çdo gjë sipas qejfit të njeriut. Por, vjen e nesërmja dhe sjell diçka të bukur. Dhe, përsëri gjërat vijnë në vend të vet...

Si reagon nga vështirimet e kalimtarëve në rrugë, në pube, duke qenë se jeni personazh publik?

- Herë jam në rrugë me kapelë, herë pa kapelë dhe ka edhe të atillë që nuk më njohin menjëherë. Pastaj, thonë: "Eeeeeeeee, po ai ishte Shemi, ore!".

U ka rastis t'u ndalë policia e komunikacionit. Si reagojnë kur shohin se je ti?

- Kur më ndal policia e nuk jam në rregull, ia nisi këngës "Xhamadani vija-vija" dhe më lëshojnë... I korruptoj me një CD timen... Jo, bëj shaka... Policia jonë është polici profesionale dhe mburrem me policinë e Kosovës.



Ndonjë moment i gëzuar a i pikëlluar që ua ka dridh zemrën në jetën tuaj?

- Kam pasur ditë të lumtura, por edhe të vështira... Ndër ditët më të lumtura ishin ato kur më kanë lindur dy fëmijët e mi: Bonisi dhe Uliksi.

Si e sheh gjendjen momentale në muzikë, në radhë të parë kur fitohet përshtypja se në Kosovë secili dëshiron të bëhet këngëtar?

- Te ne më nuk dihet kush ha e kush pi... Kjo ma kujton thënien e një tim miku: "Rrota që sillet e kurrë nuk ndalet, ka vlera të dyshimta". Por, kujt i bëhet vonë për këtë?! Ata prapëseprapë me tallave...

Ç'mendim ke për këngëtarët e rinj të Kosovës?

- Ka talent të rinj... Ka edhe të tillë që vështirë depërtojnë se kushte nuk kanë. Të tillët, edhe pse kanë ide, në idetë e tyre askush nuk beson e as nuk investon! Në anën tjetër, këngëtarë kualitativ ka shumë pak, shkaku se te ne nuk ka kriter dhe çdo gjë shkon në mënyrë stihike... E, nesër del një dikush dhe i thotë vetit: Jam këngëtar se jo mahi!

Si ka qenë rinia jote?

- Rinia ime ka qenë shumë dinamike. Si i ri kam filluar të këndoj dhe kam pasur një shoqëri fantastike, të mrekullueshme.

"Memoaret i shfletoj, dy pika loti më pikojnë", janë vargje të një kënge tuaj. A bën ta dimë se në ç'kohë ndodhi dashuria jote e parë, a ia ke hapur zemrën dhe nga ishte ajo?

- Dashuria? Ndjenjë e mirë, por përherë kam dirigjuar me ndjenjat e mia... Zemrën duhet femra me ma hap, e jo unë asaj... S'ka pasur filozofi tjetër... Kështu kam menduar si i ri.

Po, dashuria jote e jetës kur ndodhi dhe si u njohët?

- Po aludoni në gruan time, a? Krejt ka shkuar shpejt... Nuk na u desh shumë kohë të mendojmë...

Jeta jote momentale tash dhe familja?

- Familja për mua është në vendin e parë. Të gjitha të tjerat janë gjëra sporadike në krahasim me te. Për ta jetoj... do jetoj... do vdes.

Me cilën shprehje, fjalë a mendim do të donit ta përfundojmë këtë bisedë?

- Një përsëritje të ngrohtë për të gjithë lexuesit e revistës "Kosovarja", revistë kjo që unë do ta kujtoj përherë me mall, sepse më kthen shuuuumë vite mbrapa, kur isha roker tinejxher.

E, të mos hyj llugave - edhe shumëçka tjetër...

("Kosovarja" nr. 4/ 2015)

Isa ILAZI



**MARIGONA
HILL**



Urime Festat e Fundvitit!



MARIGONA[®]
SUN



Urime Festat e Fundvitit!



COURTYARD[®]
BY MARRIOTT


Prishtina


Gëzuar Vitin e Ri 2026!

Përjetoni mikpritje të pakrahasueshme në zemër të Prishtinës.

Ju ftojmë të festoni me ne dhe të krijoni kujtime të paharrueshme në Courtyard by Marriott Prishtina.

Udhëtimi i elegancës vazhdon përtëj kësaj faqeje. Abonohuni për përditësime ekskluzive dhe na ndiqni në rrjetet sociale për frymëzim të përfjetshëm.





Leonora Bruçaj - Keka

N'dyzet zemrash e një rruge

Sonte, mbrenda heshtjes qiellore,
m'u kujtue hapi i parë
kur fjala u bënë dritë,
e drita u bënë shteg
ku dy shpirta u takuen
si me qenë kushtrime t'vjetra
që pritshin me u zgju n'kohe.

Atëherë, nuk dijsa
se n'nji buzëqeshje t'vetme
mundet me u mshef krejt bota,
se n'nji shikim t'qetë
mundet me u ndez krejt jeta,
se n'nji frymëmarrje t'afërt
mundet me u gjet strehimi i plotë.

Ti erdhe si pranverë
që sjell aromë t'pa thanun,
si shi i imët n'muaj t'thatë
që s'ban zhurmë, po veç gjallnon.
E unë u bënë tokë
që t'ta mbaj hapin,
qiell
që t'ta ruaj ëndrën,
e dhembje
që t'ta zbus kur bota trazohet.

Ka njëzet vjet
që dita ime nis me emnin tand të pashpallun,
që nata jem qetësohet
tu e ndie erën e mirë t'qenies tande.
Ka njëzet vjet
që koha m'ka msue
se dashnia s'është zjarr që djeg,
po një dritë që rri e ndezun n'shpi,
edhe kur bjen nata më e zezë.

E ndoshta
Zoti kur i ka endë rrugët tona
ka qeshë me vete,
se e ka ditë
që prej asaj dite e sod e mot,
unë s'kam me qenë ma ajo që isha,
por ma e plotë,
ma e gjetun,
ma e rritun n'dashni e n'dritë.

Nëse sonde yjet heshtin,
asht pse po na ndigjojnë,
se e dinë që dashnia jonë
s'ka nevojë për fjalë të mëdhaja,
ajo rri n'sytë e tu,
në hapin tand,
në paqen që ma falë
kur bota rrotullohet ndryshe.

Edhe kur jam lodhë
e kur shpirti m'asht thy
si kupa që bie n'tokë,
ti m'ke mbledhë me butësi
si me qenë qelq i shtrenjtë,
e m'ke rrujtë
si jetë që t'është falë me amanet.

Asht njëzetvjetor, po jo fundrrugë;
asht veç një kthesë e bukur
ku shikoj prapa
e gjej një grusht kujtime që marrin frymë,
edhe shikoj para
e shoh një det t'qartë
ku lundrojnë ëndrra
që s'kemi arritë me i thanë ende.

Sonte, t'falemnderës
për çdo ditë që më ke bënë me e dashtë,
për çdo natë që më ke bënë me besue,
për çdo hap që më ke bënë me ecë ma lehtë.
E nëse ka një mrekulli n'këtë jetë,
ajo asht takimi ynë i parë —
ai çasti i pashlyshëm
që prej atëherë
ma shkroi jetën me dritë

(05.12.2015)

Heshtja që flet me emrin tim (Si ike nga kjo botë)

Në kthinat e heshtjes ku nata pushon
kam lënë një dritë të ndezur,
atë dritë që s'fikat kurrë
edhe kur qielli i shpirtit rrëshqet në mjegull
e zemra tretet nën peshën e kujtimeve të papritur.

Ka çaste kur ajri rëndon
si një faqe libri e palexuar,
ku secila shkronjë përmban një copëz fryme
të atij që dikur ecte para meje,
me hapa që s'i dëgjoj më,
por i ndiej më fort se zhurma e botës.

Më mungon çdo mëngjes
si një fjalë që s'mbërrin në buzë,
si një bekim i ndalur në gjysmë,
si një dorë që kërkon dorën time
nëpër labirinte që vetëm shpirti i njeh.

Koha më mëson t'i mbaj sytë hapur,
por shpirti më mbyllet
sa herë prekem me kujtime
që ecin butë si era e parë e pranverës
dhe djegin si mbërmet e vona të dimrit.
Diku mes këtyre stinëve të zëna në mes
rri i qetë ai vegim i pandashëm,
drita që më prin
edhe kur më rrëzohet bota nën këmbë.

Çdo ditë flas me heshtjen
dhe ajo më përgjigjet me një qetësi të thellë,
si të më thoshte:
"Jam këtu. Jam pranë.
Nuk jam larg sa mendon."
Dhe unë e di.
E di sepse s'ka kurrfarë shkëputjeje
që mund të ndalë një ndjenjë
të skalitur në palcë të shpirtit.

Në çdo hap që bëj,
dyfishon prania jote e padukshme,
një fillad i ngrohtë që s'ka emër,
por ka peshë,
ka kujtesë,
ka atdhe brenda zemrës sime.

Ndonjëherë më duket
se yjet më vështrojnë me sytë e dikujt
që e di dhimbjen time,
se nata më mbulon me një pelerinë
që dikur mbante aromën e shtëpisë,
dhe unë eci nën të,
me trup të lodhur
por me shpirt që s'e dorëzon dot mallin.

Po, ka plagë që ngelin të hapura,
por ka edhe dashuri
që kurrë s'arrin të thahet.
Dhe kjo,
kjo është e jotja brenda meje:
një amshim i qetë,
një pranverë që nuk çel,
por nuk vyshket kurrë.

Në fund
çdo shpresë që kam,
çdo buzëqeshje që guxoj t'i jap botës,
çdo rreze drite që më prek në mëngjes,
është një mënyrë për të thënë
atë që fjala s'e ka fuqinë ta shprehë:
se je këtu...
se do jesh gjithmonë...
në një vend ku s'preket,
por ndihet më shumë se gjithçka tjetër

Ndarja

Kur ikja u bë heshtje

Nuk pati britmë,
as fund të zhurmshëm fjale —
veç një heshtje që ra si pëllhurë mbi kujtime,
dhe hapat e tu u tretën në dritën e mbrëmjes.

Nuk të ndala.
Sepse dashuritë e vërteta nuk zvarriten —
ato digjen qetë,
derisa flaka u kthehet në kujtim të ndritshëm.

Tani, çdo mëngjes më vjen me një hijeshi të ftohtë,
si gjethe që rrotullohet pa adresë,
dhe unë —
në çdo frymë, ndiej mungesën tënde të bukur,
si një poezi që s'ka më autor.

Mësova se ndarja nuk është fundi,
por arti i lënies pas,
i ruajtjes së asaj që s'mund të mbetet,
as dhimbje, as mall.

THIRRJE

O popull i vjetër, i lodhur n'vuajtje,
me plagë n'histori e shpresë n'këmbëngulje,
kemi ecë n'terr, n'uri e n'gjak,
po shpirtin kurrë s'na e theu as plumbi n'prag.

Na ndau mërgimi, po s'na ndau gjaku,
prej dheut t'huej u kthym te pragu,
me votë n'dorë e besë n'zemër,
me e ngritë vendin n'dritë e emër

Mos i harroni t'parët tanë,
që ranë për prag, jo për emën,
se heshtja vret, po fjala çon,
e vota sot asht komb në fron.

Betohemi sot — për prag e për dhe,
me u ba një zë, një mend, një fe
me dalë n'votë, pa frikë, pa pritë,
se zëri i popullit asht dritë.

Leonora Bruçaj - Keka

Si e quajnë farmacistët atë që blen kondom?

Në Kosovën tonë shtet i pavarur dhe sovran, frika më e madhe është se mund të bëhesh për doktor e shëndetësia, siç thonë shumëkush, është në kolaps! Edhe nëse ke fatin të të mos dhemb askund, si të hysh në barnatore për të blerë çka do qoftë, ti për farmacistët a farmacistet je pacient! Kështu, pra, të quajnë farmacistët edhe nëse aty je për të blerë kondom për seks të sigurt!

Hapa derën e një barnatore në Prishtinë. Farmacistja, e cila po fliste në telefon, e ndërpreu muhabetin me bashkëbiseduesin.

"Të thërras më vonë, sepse e kam një pacient!", i thotë teksa e ndërpreu lidhjen telefonike.

"Kështu i quani ju klientët tuaj?!", nuk u durova pa i thënë paksa me të qeshur.

"Kështu u thonë të gjithëve që vijnë në barnatore!", ma ktheu ajo.

"Unë nuk jam e sëmure, por dua pika për hundë për vajzën time se është pak e ftohur", ia ktheu.

Dhe, pasi i mora pikat për hundë dhe ia bëra pagesën, dola nga barnatorja, por mendja më mbeti te fjala pacient...

A DUHET T'I BLEJMË KONDOMËT NË BUTIK?

Për të sqaruar më mirë këtë situatë, të rikujtojmë se në barnatore mbajnë edhe pampersa, ushqim për foshnje, kozmetikë,

kondom për seks të sigurt etj.

Sido që të jetë, sapo të hapësh derën e barnatores, automatikisht për farmacistët ti je pacient!

Je pacient edhe nëse blen ngjyrë për flokë, buzëkuq etj.

Je pacient edhe nëse blen ushqim për foshnje të firmës së njohur HIP, apo edhe një shishe për të ushqyer foshnjën!

Madje, je pacient edhe nëse blen kondom për seks të sigurt!

Pra, më e keqja e tërë kësaj është se edhe nëse njeriu më i shëndosh hyn në barnatore, farmacistët e quajnë pacient!

Thënë shkurt, sipas farmacistëve ne jemi "shoqëri e sëmure", një shoqëri që nuk të të pyet kush të pëlqen a s'të pëlqen termi pacient edhe nëse je shumë i lumtur e nuk të dhemb askund!

Shterohe pyetjet:

Kush ishte ai budalla që e shpiku këtë term për klientët?

Si ka mundësi që njerëz të shkolluar, siç

janë farmacistët, e përdorin këtë term vend e pa vend?

MOS U BËFSH PACIENT!

Farmacistëve as që u shkon në mend se sa keq është t'i godasësh njerëzit me fjalën pacient, nëse ata, vërtet, nuk janë të tillë, sepse në Kosovën tonë shtet e keqja më e madhe është nëse bëhesh për doktor, kur dihet se në ç'kushte punon shëndetësia jonë, kur xhepat janë shprazur moti nga varfëria që e ka kapluar një pjesë të madhe të popullatës sonë. E, për mjekim privat mos të bëftë Zoti se ta marrin edhe shpirtin për para pate a s'pate, pate nevojë a s'pate nevojë, vetëm e vetëm që t'i vizitosh e paguash më shpesh!

Thënë shkurt, sidoqoftë, i rrjepur je! Prandaj, fjalët që i përdorim më së shpejti në Kosovën tonë shtet janë "Ishalla jemi shëndoshë!"

Diturie Haxhaj

NJË FILLIM I RI,
PËR FAMILJEN TUAJ.

Eliza Park A

+383 44 106 777
www.cimaks.com

Kur shpirti flet shqip: rëndësia e trajtimit psikologjik në gjuhën amtare



Në të gjitha gjuhët mund të flasim, por kur na dhemb shpirti, vetëm shqip bërtasim. Kjo nuk është vetëm një shprehje poetike, por një e vërtetë njerëzore e thellë. Njeriu mund të zotërojë shumë gjuhë, por ajo e para, gjuha e nënës, është e lidhur ngushtë me emocionet, kujtesën dhe identitetin. Për ne shqiptarët, ajo gjuhë është shqipja dhe në të gjejmë strehë, kuptim dhe shërim.

Në trajtimin psikologjik, gjuha nuk është thjesht mjet komunikimi, por rruga për të hyrë në botën e brendshme të njeriut. Kur trajtimi zhvillohet në gjuhën amtare, lidhja midis profesionistit dhe personit që kërkon mbështetje bëhet më e drejtpërdrejtë dhe më e ndjeshme. Fjalët marrin ngjyrën e shpirtit dhe e bëjnë më të lehtë rrugën drejt qetësisë.

GJUHA E PARË, GJUHA E NDJENJËS

Që në fëmijëri, truri ynë mëson të lidhet me botën përmes zërit, tingujve dhe fjalëve. Kur një nënë thotë “mos u tut”, “që Nona ku osht”, ose “të dua”, ato fjalë mbeten në kujtesë si ndjesi sigurie dhe dashurie. Kështu, gjuha amtare bëhet një strehë emocionale që mbart kujtimet

më të hershme dhe më të thella të jetës sonë. Studime të shumta psikologjike tregojnë se emocionet përjetojnë më fort në gjuhën amtare. Truri reagon më fuqishëm ndaj fjalëve emocionale në gjuhën e parë sesa në një gjuhë të huaj. Në momentet e dhimbjes, trishtimit apo dashurisë, njeriu kthehet natyrshëm tek ajo gjuhë ku përjetimet janë ruajtur që në fillim. Kur flasim për ndjenjat tona në një gjuhë të huaj, ato shpesh tingëllojnë më të largëta, më të ftohta, sikur të mos ishin plotësisht tonat. Por në gjuhën amtare, fjala del e ngrohtë, e sinqertë dhe e mbushur me ndjenjë.

FJALËT QË NA SHËROJNË

Në trajtimin psikologjik, një nga hapat më të rëndësishëm është të mësojmë t'i emërtojmë ndjenjat tona. Të thuash “po tutna” është një mënyrë për ta njohur dhe kuptuar veten dhe për të nisur shërimin. Por për ta bërë këtë, njeriu ka nevojë për fjalët e duhura dhe ato zakonisht i gjen në gjuhën e nënës. Në shqip, sidomos në gegnisht, ndjenjat kanë thellësi e ngjyra që shpesh nuk përkthehen dot: “shpirti po m'dhemb”, “po m'nxehet kryet, prej ankthit si me pas një saq përmi”, “po ma nin zemra”, “nji lëmsh m'u ka bo n'bark”. Secila prej këtyre shprehjeve bart një ndjesi që përfshin trupin, mendjen dhe shpirtin.

Kur një person në trajtim flet shqip, ai nuk përpiket vetëm të përshkruajë emocionet, por i përjeton ato sërisht në mënyrë të plotë. Fjalët bëhen ura që lidhin atë me kujtimet, me përjetimet dhe me vetveten. Dhe aty, pikërisht në këtë proces, fillon shërimi i vërtetë.

KULTURA SHQIPTARE DHE PESHA E FJALËS

Sa herë kemi parë në familjet tona një nënë që e mban brenda dhimbjen dhe thotë “kalon”, një baba që hesht sepse “nuk qan burri”, një të ri që ndihet i vetëm në mërgim sepse nuk gjen dot fjalë në gjuhën e vendit për atë që po i ndodh brenda. Në këto çaste, trajtimi në shqip nuk është luks. Është mbështetje, një mënyrë për t'i dhënë zë asaj që për vite ka qenë e pashprehur.

Ne themi: “Fjala të nderon, fjala të rrëzon” Fjala për ne është përgjegjësi, por edhe dashuri, ngrohtësi dhe afërsi. Për këtë arsye, trajtimi në shqip ka një domethënie të veçantë, sepse prek jo vetëm mendjen, por edhe kulturën dhe shpirtin tonë kolektiv.

Një profesionist i shëndetit mendor që e njeh kulturën shqiptare e kupton ndryshe peshën e heshtjes, kuptimin e turpit, të nderit, të mallit, apo të sakrificës për familjen. Ai kupton se një “se di çka po m'munon tash se tana i kom” shpesh mund të fshehë një botë të tërë dhimbjeje e trishtimi, madje edhe të trashëguar. Prandaj, për shumë shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, trajtimi në shqip është më shumë se një mbështetje profesionale, është një rikthim në rrënjë, një mënyrë për t'u ndier sërisht vetvetja.

TRAJTIMI SI VEND SIGURIE NË GJUHËN E ZEMRËS

Trajtimi psikologjik është një hapësirë ku njeriu dëgjohet, pranohet dhe respektohet. Kur kjo ndodh në gjuhën amtare, ndjenja e sigurisë rritet. Njeriu ndihet i kuptuar plotësisht, pa pasur nevojë të kërkojë fjalët apo të shqetësohet se mos keqkuptohet. Gjuha amtare sjell qartësi dhe lehtësi dhe kjo e bën procesin më të natyrshëm.

Në diasporë, shumë shqiptarë thonë se disa ndjenja “nuk dinë t'i shprehin” në gjuhën tjetër. Kjo është e kuptueshme, sepse emocioni kërkon rrugën që njeh më mirë dhe ajo është gjuha e nënës. Kur njeriu fillon të flasë shqip për atë që ndien, ndodh diçka e thellë: fjalët bëhen çlirim dhe shpirti fillon të marrë frymë më lehtë.

RUAJ GJUHËN, RUAJ SHPIRTIN

Në një botë që ndryshon shpejt, ku fëmijët tanë rriten me shumë gjuhë dhe kultura, është thelbësore të mos humbasim lidhjen me shqipen. Gjuha amtare nuk është vetëm mjet për të komunikuar me të afërmit, por është çelësi i emocioneve dhe i identitetit tonë. Një fëmijë që mëson të shprehë ndjenjat e veta në gjuhën e prindërve, rritet me ndjenjën e përkatësisë dhe kuptimit të vetvetes.

Për të rriturit, ruajtja e gjuhës është ruajtje e kujtesës dhe e shpirtit. Sepse gjuha është mënyra se si kujtojmë, dashurojmë dhe shërohemi. Siç ka thënë Fan Noli: “Gjuha është gjaku i shpirtit të një kombi.” Dhe në trajtimin psikologjik, kjo fjalë bëhet e gjallë çdo ditë, sa herë që dikush gjen guximin të flasë në gjuhën e vet për shpirtin e vet dhe për atë që brenda dita-ditës e vret. Kur shpirti shprehet në shqip, çdo qelizë e ndëgjon dhe shërimi fillon.



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

BELIEVE IN NEW YEAR OFFER



START THE YEAR IN A BEAUTIFUL **SEA-VIEW ROOM**

Enjoy a warm welcome at reception.

Find a special Santa's gift waiting in your room.

31.12.2025

LUXURY SPA ACCESS
at Zen Spa

NEW YEAR'S EVE GALA DINNER
at Mandarin Restaurant

FIREWORKS SHOW
at Resort

EXCLUSIVE PARTY
at Lime Lounge

**ticket-only access - 3000ALL*

TEST YOUR LUCK
at Marina Casino

01.01.2026

NEW YEAR'S BREAKFAST
at Mandarin Restaurant

FIRST BRUNCH OF THE YEAR
at Lime Lounge

MARINA CINEMA
at Conference Hall

22.200 ALL / pax

Start Planing your Festive Experience
+355696041000 info@marinabay.al | www.marinabay.al

Pse ne, shqiptarët, ndahemi në vend se të martohemi?

Kohë pa kohë. Shumë çifte të rinjsh bashkëjetojnë dhe kur vjen koha që dashurinë e tyre ta kurorëzojnë me martesë - ndahen!

E, edhe më keq, edhe ata që janë martuar pas një kohe po i japin fund martesës... Pse?

Është bërë trend jo i mirë që ne, shqiptarët, në vend se të martohemi – ndahemi.

E, se është kështu dëshmojnë të dhënat e rritjes së numrit të shkurorëzimeve në Kosovë.

Vetëm brenda dhjetë muajve të vitit 2025 mbi 1 mijë e 300 çifte i dhanë fund martesës së tyre!

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë periudhës janar–tetor 2025 në Kosovë janë regjistruar gjithsej 1341 shkurorëzime, duke treguar një nivel të konsiderueshëm të çifteve që i kanë dhënë fund martesës së tyre. Vetëm gjatë muajit tetor janë regjis-

truar 158 raste të shkurorëzimeve të ndodhura në Kosovë!

Krahasuar me muajin shtator, ky numër paraqet një rritje prej 18.8 për qind të çifteve të shkurorëzuara.

“Sa u përket shkurorëzimeve të ndodhura në Kosovë për muajin tetor janë 158 raste dhe krahasuar me muajin shtator kemi rritje të numrit të çifteve të shkurorëzuara për 18.8 për qind”, thuhet në raportin e ASK-së.

PSE NDODHIN SHKURORËZIMET SIPAS TË ANKETUARVE TANË?

Arsyeja kryesore e ndarjeve, sipas të anketuarve tanë, janë zënkat, meqë

kanë mosmarrëveshje të çuditshme. Pastaj, vjen tradhtia si problem i pakapërcyeshëm e që sjell ndarjen, sepse më nuk kanë besim në njëri-tjetrin, e më pas mbajtja fshehtë e së kaluarës, konkretisht të gënjyerit.

Dhe, në fund, në ndarjen e çifteve rol të rëndësishëm ka gjendja e rëndë materiale, meqë shumë të rinj nuk kanë vend pune shkak i papunësisë së madhe në Kosovë.

Sidoqoftë, nëse vazhdohet me këtë trend, pas disa vjetësh pak çifte në Kosovë do të mbesin bashkë, e edhe ata kryesisht pleq e plaka! Keq, a?

Diturie Haxhaj

NJË PËRVOJË UNIKE DHE EKSKLUZIVE

në zemër të Ferizajt



Unë vuaja, ti gëzoheshe!

Në dasmën tënde isha mysafir. Ti ndodheshe jo larg meje e veshur me vello të bardhë, e që të jepte pamje madhështore. Në dorë mbaje buqetën me lule, ndërsa mbi flokët valëzore korb të zi mbaje kurorën plot shkëlqim, e që vezullonte si rreze drite...

Veli i bardhë mbi shpinë të jepte pamje artistike.
Bukuria jote në sallën e mbushur me njerëz nuk linte femër pa ia kaluar për hijeshinë që ta ka dhuruar natyra, perëndia.
Sytë e bukur si kokrra ulliri të zi i kishe drejtuar kah burri yt...
Kulmi i atij spektakli ishte kur ti dhe yt burrë dolët në mesin e të ftuarve dhe nisët të vallëzonit.
Ishte një vallëzim si në filma e që, si duket, e kishit ushtruar një kohë të gjatë...
Kur u kthyet në fronin tuaj, s'di nëse me dashje a pa dashje më shikove

gjatë e gjatë, e që ai shikim për mua ishte një thikë në zemër në atë natë që shpirti im vuante më shumë se herë të tjera.
Isha i emocionuar tej mase.
Zemra më rrihte shpejt...

DHURATA BEFASUESE...

Në ato çaste shikimi yt me timin u ndeshën siç ndeshën luftëtarët në fushën e mejdanit!
E, derisa këngëtari këndonte këngë që i kushtoheshin dashurisë, ti më shikoje vazhdimisht derisa njëri nga të pranishmit u afrua afër teje dhe ta dhuroi një djep të vogël, e që ti u

befasove shumë...
Mirëpo, në çast ndjeva një urrejtje ndaj teje: Në vend se do e përkundësh djepin që do duhej ta dhuroja unë, ti do e përkundësh djepin e tjetrit!
Ah, jetë, e solla në mendje dhe një errësirë më doli para syve të mi, e që bëri t'i ndërprisja mendimet...
E, kur erdha në vete, në mendje më silleshin fjalët: "Dashuria ime, sot, në vend se të të urreja, të dua më shumë se asnjëherë më parë!"
Dhe, pa një e pa dy, ngadalë, që të mos hetohesha nga pjesëmarrësit, dola jashtë me sytë mbushur lot...

S. M.

Culaccino Restaurant



Ushqim i përkryer: parangrënje, pasta perfekte, specialitete mishi, peshk dhe fruta deti, të shërbyera në një ambient elegant, të pastër dhe të dizajnuar me shumë shije. I njohur për mbrëmjet festive me artistë të njohur, Culaccino krijon një atmosferë që po përflitet jo vetëm në Prishtinë.



**E HËNË-E PRËMTE 7:00-00:00
E SHTUNË: 12:00-00:00**

PRISHTINË PEJTON

CULACCINO

INSTAGRAM: CULACCINO. PRISHTINE

E martuar po, burrë s'kam!

Jam Zana, nga Prizreni, 50-vjeçare, e braktisur nga burri. I kam dy fëmijë të rritur, por ende nuk punojnë. Jetoj nga ndihmat e vëllait...

Para 30 vjetësh më fejuan prindërit pa më pyetur fare me një djalë të fshatit të dajave. Ai punonte mësues në fshat. Atëherë ishte kulmi i lumturisë nëse fejoheshe me mësues, sidomos në rrethin ku edhe u fejova unë.

Kështu, unë, edhe pse e njihja pak, nuk kundërshtova fare.

Megjithëse, në atë kohë, edhe po të mos më pëlqente fejesa, kush guxonte të kundërshtonte...

Pas fejesës, burri im i ardhshëm u regjistrua në shkollë të lartë në Prizren dhe zuri të fliste se nuk do më merr për grua, mua, kinse prizrenasen e lazdruar, ani pse vetë e pat qar mesitin të më lypte.

Kështu, kaluan dy vjet...

Kur ai e kreu shkollën e lartë, babai im e qoi mesitin tonë që të merreshim vesh a do më marr ai për grua a jo.

"O merre menjëherë, o lëshoje menjëherë!", e kishte porositur mesitin që t'ia përcillte të fejuarit tim.

BURRI ME MUA KA FJETUR VETËM NATËN E PARË TË MARTESES!

Dhe, ai vendosi t'më merrte. Por, me mua ka fjetur vetëm natën e parë të martesës! Kurrë më!

Atë natë ka qenë i mirë. Kam jetuar tutje me të në të njëjtën shtëpi, por kurrë më në të njëjtin shtrat. Kurrë më me mua nuk ka folur për shtrat.

Pse?

Nuk e di.

Ndoshta pse unë nuk i kisha shkuar e virgjër, meqë me një fqinj timin kishim pasur shumë herë marrëdhënie seksuale, sepse e donim njëri-tjetrin, por nuk kishim guxim ta përmendnim martesën, meqë familjet tona ishin të hasmëruara ndërmjet veti... Edhe pse aso kohe e kisha të kryer vetëm shkollën fillore, kisha bukuri të rrallë, e që të rinjtë më vardiseshin sa herë që dilja në qytet.

Më lakmonin të më kishin dhe arriti t'më kishte vetëm fqinji.

Familja e burrit tim sillej jashtëzakonisht mirë me mua, por asnjëherë nuk kam pasur guxim ta hap me vjehrrën problemin tim: se djali i saj, veç natës së parë, kurrë më nuk kishte fjetur në shtrat me mua... Prej natës së parë, për fat timin, mbeta shtatzënë.

Pas nëntë muajsh linda binjakë: djalë e

vajzë. Të mirë e të shëndoshë si drita... Prindërit nuk më lejonin të ndahesha, ani pse, më në fund, ua thashë troç të gjitha... "Herë do kur do të kthehet te ti", më thoshin, por vetëm të kisha durim.

SI E MORI IM BURRË NXËNËSEN E VET?

Ndërkohë, burri im zuri punë në njërën nga shkollat e komunës së Prizrenit dhe pas tre vjetësh mori një nxënëse të veten. Tash mu shtua edhe një problem: ortakja. E, prindërit përsëri nuk më lejonin të ndahesha, duke m'i thënë fjalët e njëjta si dikur - se ai do më kthehet herë do kur... Dhe, kur panë që ai nuk kishte kthim, prindërit më thanë t'ia lija fëmijët e të gjeja burrë tjetër. Por, mua nuk më bënte zemra të ndahesha prej tyre...

Tash po bëhen shumë vjet që i mora fëmijët dhe e braktisa tim burrë, ani pse me dokumente nuk jemi ndarë. Jetoj me nënën, meqë babai ka kohë që më ka vdekur.

Jetoj në shtëpinë time që ma ndërtoi vëllai i madh, e që jeton e punon në Zvicër. Sidoqoftë, edhe pse më ka munguar gjithmonë ta kem një mashkull në shtrat, nuk jam pishman që i kam ruajtur fëmijët, që jam flijuar për ta...

Zana, Prizren




Happy
New Year



GLAMOUR

Për rezervime na kontaktoni në Instagram: [glamourevnts.pr](https://www.instagram.com/glamourevnts.pr)



Gruaja ime ia fut gjumë dhe s'i intereson kush fiton!

“Lej lajmet se kurrë s’do të bëhet mirë!”, më thotë gruaja dhe ia fut gjumit, sepse nuk i intereson se kush fiton a kush humb!

Një fallxhi ia shikon shuplakën e dorës fqinjit tim.

I thotë: “Sivjet keq. Shumë zi po del. Keq shumë... Nuk të kisha thënë të punosh asgjë, sepse nuk po të del mirë!”. “Po, shiko, he burrë, atëherë, vitin tjetër çka do të bëhet?”, i thotë ai dhe ia jep dorën tjetër.

“Njëjtë, he burrë. Keq shumë po të del, përsëri. S’ka bereqet fare!”.

“Pa shiko, pra, pas tre vjetësh, a po ndryshon gjë?”.

“Pas tre vjetësh më mirë po del. Po bëhet mirë”.

Kjo bëri që ai tash të merr frymë

thellë, në shenjë të qetësimit shpirtëror...

“Eh, më në fund, e kapi! E dija se diku duhet ta rroki puna, se Zoti ka thënë “punëtori ma merr me zor”, foli ai.

“Nuk po del më mirë, por mësohesh me varfëri dhe të vjen sikur me pasur pasuri!”.

**GRUAJA IME
IA FUTË GJUMË DHE
SE KA GAJLE PËR ASGJË!**

Për çudi, unë, teksa rropatesha më lajmet e ditës, gruaja ime ja fut gjumë

dhe kur e pyes se a e ka ndie erën e fortë që ka fry natën, thotë: “Jo more, çfarë ere, a ëndërr je a?!”. As nuk sheh ëndërr, as nuk e prishë gjumin, as nuk e prishë të nesërmen...


“Heu, po mirë”, them me vete, tek fle ajo me një gërhisje që ndihet, ndosh-ta, edhe te fqinjët.

E unë, budallai, i bëj sytë “katër” teksa i dëgjoj lajmet, debatet televizive, kumtesat e partive politike dhe të KQZ-së derisa nga lodhja e dremitja e madhe më zë gjumi.

S. M.



REVOLUCION NË DOBËSIM, 20+ QENDRA NË BOTË



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova në Prishtinë, Kenda Center u pozicionua që në fillim si një risi në tregun e Kosovës, duke vendosur standarde të reja në mirëqenie, shëndet dhe formësim trupi. Falë rezultateve reale dhe besimit të klientëve, qendra u zgjerua shpejt në disa qytete të vendit. Sot, Kenda Center është një emër ndërkombëtar me mbi 20 qendra aktive në mbarë botën, duke dëshmuar fuqinë e rezultateve dhe suksesin e qëndrueshëm.



Përforcoje
vetën



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shendetin

FILLO TRANSFORMIMIN TËND SOT



PRISHTINË

+383 45 224 540



PRIZREN

+383 43 900 902



GJILAN

+383 45 505 043

Në martesë a rrejnë më shumë meshkujt a femrat?

Femrat rrejnë sepse nuk duan ta lëndojnë partnerin, kurse prapa rrenave të meshkujve më së shpeshti fshihet një ego e fortë. Meshkujt rrejnë më shumë se femrat, thonë psikologët. Mesatarisht, meshkujt i thonë tri rrena në ditë, përkatësisht rreth 1000 rrena në vit, derisa femrat thonë rreth 365 rrena më pak.

FEMRAT I MUNDON NDJENJA E FAJIT

Meshkujt, duke qenë robër të egos, zmadhojnë suksesin në punë në mënyrë që ta bëjnë femrën për vete. Edhe pse 75 për qind e meshkujve dhe femrave mendojnë se disa rrena janë të arsyetuara, sepse parandalojnë grindjet, ndjenja e fajit më shumë i mundon femrat. Edhe ekspertët pajtohen se rrenat e

vogla mund të jenë të mira. Ata thonë se edhe ato, nëse bëhen shprehje, mund ta rrezikojnë lidhjen. Meshkujt më së shumti rrejnë rreth asaj se sa kanë pirë, kurse femrat rrejnë më së shpeshti për ta fshehur zemërimin, p. sh., për shkak të ditëlindjes së harruar.

RRENAT E MESHKUJVE

- Nuk kam pirë edhe aq shumë;
- Nuk kisha qasje në celular;
- Jo, nuk dukesh e trashë, aspak;

- Kam pirë vetëm një birrë;
- Në punë çdo gjë është ok, kompania qëndron mirë.

RRENAT MË TË SHPESHTA TË FEMRAVE

- Çdo gjë është në rregull, mirë jam;
- Nuk kushtoi shtrenjtë;
- Edhe pesë minuta e jam gati;
- Më dhemb koka;
- Këtë e kam me vite.



Adresa: Rruga B. Kompleksi Royal C15/C16
10000 Prishtinë - Kosovë

 /fortesa__boutique

Kontakti: +38349641000

Adresa: Prishtina Mall,
Kati I

 /fortesa_prishtinamall

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A bën ta kërkojmë vajzën e mikut për djalë?

Përsëndetje zonja magjistare! Jam nënë e dy fëmijëve. Jetoj në Zvicër. E kam djalë të madh për martesë dhe jemi bërë merak ta kërkojmë vajzën e mikut për djalë. Por, punët nuk po ecin si duhet në këtë drejtim...

A mos kemi gabuar që i kemi hyrë kësaj pune?

"Shqiptarja e Zvicrës"

Përgjigje:

Zakonisht, kur miqësia do të trashet më tej, ai që në këtë rast bën propozim është pala e familjes që e ka vajzën.

Në rastin tuaj, familja e mikut do të duhej ta hapte këtë temë e jo ju. Sepse, vetëm në këtë mënyrë do të vazhdonte miqësia me trendin e vjetër mes jush.

Por, kur familja e djalit e kërkon vajzën e mikut, gjërat mund të mos shkojnë më si dikur...

Megjithatë, shoh se do të plotësohet dëshira juaj, sado që gjërat po lëvizin me zor...

Kam probleme me gruan...

Jam një burrë nga Ferizaj, 51 vjeçar. Jemi familje me traditë. Bashkëshortja ime punon, por kam dyshime se nuk rri si duhet në punë...

Çka të bëj, të lutem?

"Ferizajasi"

Përgjigje:

Nuk do ishte keq ta presësh gruan afër vendit të punës dhe ta marrësh në shtëpi, sepse ashtu do ia lehtësosh edhe udhëtimin.

Prandaj, duhet ta gesh arsyen e kësaj vonese, sepse je burri i zonjës që vonohet dhe nuk duhet ta tolerosh që i njëjti avaz të përsëritet çdo ditë...

Ta lë fakultetin për personin që më do, apo?

Përsëndetje zonja magjistare, jam në vitin e tretë të fakultetit ekonomik, studente e zellshme dhe e kam kryer në afat çdo provim.

Ka dy vjet që jam me një djalë, i cili punon në biznesin e babait të vet. Por, ai nuk do që unë të rri në Prishtinë dhe të studioj.

Para një muaji më ka vënë kusht që nëse dua të fejohej me të duhet të heqë dorë nga fakulteti, sepse thotë se do të kem punë në biznesin e tyre familjar.

E dua shumë, por jam në dilema të mëdha se çka të bëj.

Më ka vënë para aktit të kryer...

Prandaj, kërkoj ndihmën tënde për të marrë një vendim: Ta kem e ta lë fakultetin, apo të vazhdoj fakultetin, por pa të?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Ashtu dhe kështu, ti je e thyer në shpirt.

Cilindo që e lë do jetë vendim i vështirë.

Megjithatë, sugjerimi im është ta vazhdosh fakultetin.

E, pse?

Sepse, kërkesa e tij vjen nga xhelozia. Dhe ti, edhe po ta lësh fakultetin tani, ai do të ndjejë xhelozinë edhe në punë. Në këtë mënyrë do të vjen edhe te largimi yt nga puna.

Andaj, nga një studente e zellshme, në prag të përfundimit të fakultetit, do të bëhesh një amvise dhe hiç më shumë.

Mos e lë fakultetin, sepse bashkëshortësia do besim e ai nuk e ka besimin...

Keq, a?

Ku ta kërkoj fatin pas ndarjes?

Jam 28-vjeçare, jetoj në Gjermani, e ndarë nga burri. Realisht e kam dashur dikë tjetër deri tre muaj pas martesës, kur edhe kam filluar ta dua burrin tim. Edhe ai më ka dashur mua sa nuk kemi parë dikë tjetër jashtë njëri-tjetrit.

Por, një ditë u zbuluan lidhjet e mia me të parin që e kisha. U grindëm shumë dhe u ndamë. Ku e kam fatin e ardhshëm?

"E divorcuara"

Përgjigje:




Ajo që del te unë është: Ju jeni akoma të mllëfësuar në njëri-tjetrin. Ai e ka ditur me kohë se ti e ke pasur atë person si ofertë me të cilin keni folur, por nuk e ka ditur se ti ke qenë me të në lidhje dhe se i keni pasur të gjitha së bashku.

Kjo e ka shokuar ish-burrin tënd, i cili do të bëjë një martesë në verën që vjen, por nuk do të jetë i lumtur me të, pasi që zemra i ka mbetur te ti, pa marrë parasysh çka ka ndodhur.

Dhe, pamundësia që ai të rehatohet me të do të bëjë që ai të të rikthehet ty përsëri dhe shoh se ju do të ribashkoheni në muajin shtator të vitit 2026.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix ks


+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC